

SI RAPORTUAN MEDIAT PËR EUROINTEGRIMET PARA DHE PAS ZGJEDHJEVE

İM@

PUBLIKIM ELEKTRONIK:

SI RAPORTUAN MEDIAT PËR EUROINTEGRIMET PARA DHE PAS ZGJEDHJEVE

(ANALIZA)

Publikim elektronik: "Si raportuan mediat për eurointegrimet para dhe pas zgjedhjeve (analiza)"

Botues:

Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup

Redaktor:

Petrit Saraçini

Autorë:

Sllobodanka Jovanovska

Dr. Sefer Tahiri

Përkthimi:

Meriton Tusha

Dizajni:

Jane Stefanov

Shkup, tetor 2024

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen e Fondit Evropian për Demokraci (FED) - European Endowment for Democracy (EED). Përmbajtja e tij nuk pasqyron domosdoshmërisht opinionin zyrtar të EED. Përgjegjësia për informacionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë publikim i takon tërësisht autorit(ëve).

PËRMBAJTJA

HYRJE 5

SLLOBODANKA JOVANOVSKA
MEDIAT DHE EUROINTEGRIMI: BUSULLA E KTHYER NË PERËNDIM, POR EDHE NË LINDJE - MAQEDONIA GJITHNJË E MË SHUMË "VIKTIMË" SESA KANDIDATE PËR BE 7

SEFER TAHIRI
POLITIKA MBI EUROINTEGRIMET NË MEDIAT SHQIPE: NGA KUSHTËZIMI DERI TE VENDNUMËRIMI 17

Hyrje

Publikimi: “Si raportuan mediat për eurointegrimet para dhe pas zgjedhjeve (analiza)”, sjell analiza autoriale nga Slobodanka Jovanovska – gazetare dhe redaktore e politikës së jashtme dhe ish korrespondente nga Brukseli, dhe prof. Sefer Tahiri – profesor universitar i gazetarisë dhe komunikimit publik, autorë të shquar me përvojë shumëvjeçare mediatike, që përfshin raportime, hulumtime dhe analiza lidhur me integrimin evropian të vendit dhe raportimin mediatik për këto procese.

Qëllimi i analizave është të detektojë narrativat kryesore dhe cilësinë e raportimit mediatik mbi procesin e eurointegrimeve para dhe pas zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të mbajtura në prill dhe maj të vitit 2024.

Përfundim i përbashkët i analizave është se kjo temë ka qenë ndër më dominueset para zgjedhjeve dhe në fushatën zgjedhore, e fokusuar kryesisht në qëndrimet “pro” dhe “kundër” ndryshimeve kushtetuese, të cilat janë kusht për vazhdimin e negociatave për anëtarësim në BE. Në këtë konfrontim, i cili rriti polarizimin dhe ndarjet në shoqëri në vija politike dhe etnike, më të suksesshme rezultuan opsionet politike që imponuan narrativat se ndryshime kushtetuese nuk do të ketë, se ato janë “shantazh” dhe “diktat bullgar” dhe se vendi është viktimë i kushtëzimit joparimor nga BE-ja.

Pas zgjedhjeve, intensiteti i raportimit për integrimet evropiane ishte shumë më i ulët dhe u përqendrua kryesisht në ngjarje të caktuara dhe transmetim të deklaratave nga zyrtarë të lartë politikë, ku në shumicën e mediave vërehet raportim për aspekte të imponuara nga aktorët politikë dhe mungesë e një qasjeje analitike dhe kritike - veçanërisht për atë që u premtua gjatë zgjedhjeve dhe për atë që u deklarua dhe u bë pas tyre. Ngecja në integrimet evropiane dhe mungesa e zhvillimeve të reja rezulton edhe me rritje të euroskepticizmit, si dhe me ngopje dhe ulje të interesimit të mediave dhe qytetarëve për këtë temë.

Publikimi është pjesë e aktiviteteve të Institutit për Media dhe Analitikë IMA, të mbështetura nga Fondi Evropian për Demokraci (European Endowment for Democracy) nga Brukseli, dhe është një kontribut në realizimin e angazhimeve të IMA-s për avancimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, përmes bashkëpunimit me institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe mediat për përballje me dëmet nga polarizimi, gjuha e urrejtjes, dezinformatat dhe sulmet ndaj mendimtarëve kritikë në media dhe në komunikimin publik.

Instituti për Media dhe Analitikë IMA Shkup

1. MEDIAT DHE EUROINTEGRIMI: BUSULLA E KTHYER NË PERËNDIM, POR EDHE NË LINDJE - MAQEDONIA GJITHNJË E MË SHUMË "VIKTIMË" SESA KANDIDATE PËR BE

Shkruan: SLLOBODANKA JOVANOVSKA

"Do të na kalojë edhe Shqipëria", parashikoi kryeministri Hristijan Mickoski më 20 shtator 2024 pas vizitës së tij të parë në Bruksel dhe pas takimeve të para me zyrtarë të Bashkimit Evropian. Ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Aleksandar Nikolloski, nxitoi ta neutralizojë temën duke thënë se, pavarësisht nëse kanë filluar apo jo negociatat, "Shqipëria nuk do të hyjë kurrë në BE". Parashikimi megjithatë u bë realitet dhe Mickoski u detyrua të tregonte virtyt dhe të përgëzonte fqinjët për hapin përpara drejt BE-së.

Lajmi, megjithatë, shkaktoi një ortek reagimesh negative në opinionin dhe mediat në vend, të cilët filluan të pyesin: ku jemi dhe çfarë po bën qeveria e re për të ndalur prapakthimin e vazhdueshëm të Maqedonisë, përveç që ankohet në Bruksel? Për të shpëtuar qeverinë nga pyetjet e pakëndshme erdhi menjëherë kryeministri hungarez Viktor Orbani, i cili përveç premtimit të ndihmës së re financiare për Maqedoninë, u ofrua që të jetë edhe ndërmjetësues në kontestin me Bullgarinë, duke dërguar porosi se Maqedonia nuk është lënë anash, se nuk është e vetmuar, se ai do të shtyjë integrimin tonë evropian dhe se, nëse të dyja vendet pranojnë, do të na ndihmojë për të zgjidhur kontestin me Bullgarinë dhe të vazhdojmë negociatat me BE-në. Pjesa më e madhe e mediave raportuan në titujt e lajmeve ofertën e Orbanit për të ndërmjetësuar, por ajo nuk mbijetoi as 24 orë, sepse Sofja tha se nuk ka ndërmend të negociojë për diçka për të cilën veçmë ka një marrëveshje me vendin.

Deklaratat e Mickoskit dhe Nikollovskit kishin qartazi për qëllim t'i paraprinin lajmit nga Brukseli për Shqipërinë, por nuk ia arritën qëllimit dhe, aq më tepër, e treguan konfuzionin në kreun shtetëror për përcaktimin më të rëndësishëm strategjik të shtetit, i cili gjen pasqyrimin edhe në media. Pas një periudhe me retorikë të fuqishme pro-evropiane, deri diku të ekzagjeruar sepse nuk u pasua me reforma, kemi hyrë në një periudhë kur "busulla" në media kthehet jo vetëm nga Perëndimi, por edhe nga Lindja, duke hapur dilema – a po shndërrohemi në "viktimë" në vend se të kandidatit për anëtarësim në BE, kërkojmë zgjidhje apo kërkojmë justifikime, a po rritet euroskepticizmi tek gazetarët, a beson ende dikush në procesin evropian të Maqedonisë dhe a jeton fare si temë hyrja e vendit në BE, apo nuk "blihet" më nga qytetari?

Analiza e pasqyrimit mediatik të integrimeve evropiane gjatë vitit të kaluar (nga shtatori 2023 deri në shtator të këtij viti) në përgjithësi tregon se tema ka përjetuar disa faza, por me një trend të përgjithshëm për "gërvishtje mbi sipërfaqe", d.m.th. të aktualizohet vetëm nëse ka ngjarje apo deklarata të politikanëve të lartë lidhur me të, dhe nëse mund të përdoret në kontekst politik të brendshëm.

Gjithashtu, është e dukshme se mediat e huaja jashtë Maqedonisë shkruajnë më shumë për zgjerimin e BE-së si proces sesa mediat vendase, edhe pse jemi vend - kandidat për anëtarësim, e procesi në përgjithësi trajtohet më shumë dhe në mënyrë më përmbajtjesore nga organizatat joqeveritare, por edhe interesimi i tyre për të po zbehet

për shkak të uljes së interesimit mediatik. Ka gjithnjë e më pak gazetarë të specializuar për këtë çështje, e akoma më pak programe të fokusuara në këtë temë (tani ka vetëm dy emisione televizive për integrimin evropian) . Në qarqet evropiane, megjithatë, kjo trajtohet si sinjal se procesi tani po ndiqet më në thellësi, gjegjësisht edhe aspektet tjera të anëtarësimit në BE, në kuptim të standardeve për sundimin e ligjit, demokracisë, për praktikat e drejta të tregut, energjinë, ekologjinë, transportin etj., e jo vetë procesi e zgjerimit, sepse gjithçka është BE. Nga ky aspekt, vlerësimi është se ndjekja e BE-së në mënyrë indirekte është edhe më e madhe se më parë, sepse për secilën temë apo standard kërkohet një pozicion apo shembull evropian.

Ndryshimet kushtetuese para fushatës zgjedhore: Lartë në rendin e ditës, të ngecura në zbatim

Teza se integrimi evropian nuk sjell përkrahje, por ka fuqi të rrëzojë çdo qeveri në Maqedoni, u tregua edhe në këto zgjedhje, në të cilat partitë ishin të ndara në frontin evropian dhe të tjera. Në periudhën para zgjedhjeve, e veçanërisht nga shtatori 2023 deri në prill të këtij viti kur filloi fushata, ndryshimet kushtetuese ishin çështja më e eksploatuar në titujt e mediave.

Pas disa muajsh katarze rreth "propozimit francez", i cili hasi në kundërshtim të fuqishëm në opinion dhe trajtim të tillë nga shumica e mediave, duke theksuar kërcënimin e supozuar nga "bullgarizimi" i integrimit evropian dhe hapjen e mundësisë për kërkesa dhe veto të reja bullgare, ndryshimet kushtetuese hynë në Parlament, edhe pse gjasat që të votoheshin dukeshin shumë jo reale. Kjo shkaktoi një valë raportimesh gazetareske, të cilat u përqendruan në temat – do të ketë zgjedhje apo do të ketë ndryshime kushtetuese, a do të pranohet apo jo "diktati bullgar", kush janë patriotët e kush janë tradhtarët..., të cilat e vendosën integrimin evropian në kontekstin e zhvillimeve të brendshme politike në vend dhe e devijuan qëllimin.

"Ndryshimet kushtetuese nga gatishmëria deri te braktisja", "Ndryshimet kushtetuese do të qepin koalicionin qeverisës", "Kemi nevojë për ndryshime kushtetuese, por jo për të bërë një numrator telefonik nga preambula", "Anulimi i marrëveshjes me Bullgarinë do të ndërpresë integrimin evropian", "Ndryshimet kushtetuese para hyrjes në BE janë shantazh" – ishin titujt dominues në periudhën para fushatës dhe pas fillimit të saj. Një pjesë e madhe e raportimeve kishin të bënin edhe me formimin e të ashtuquajturit Front Evropian, dhe mbi të gjitha me dilemën se a do të udhëhiqet nga LSDM-ja apo ajo do të mbetet vetëm, a do të hyjë BDI-ja, e më vonë - a ia mori BDI-ja idenë e frontit evropian LSDM-së dhe vallë e ktheu atë nga një front evropian në nacionalist, ose sipas vlerësimeve më të buta - shqiptar.

Raportimet kryesore mediatike, megjithatë, u përqendruan në forcat politike në ardhje, të cilat, siç doli në fund, e keqpërdorën me sukses temën e integrimit evropian për të fituar zgjedhjet, pa ofruar zgjidhje të qarta se si do të përmbushnin kushtet për vazhdimin e negociatave me BE.

Hulumtimi i Institutit për Studime të Komunikimit (ISK) për matje të narrativëve të dëmshme politike e dha pamjen më të mirë të mënyrës sesi media e mbuloi fushatën dhe zgjedhjet, duke përfshirë integrimin evropian si një nga temat më të shfrytëzuara në atë kohë. Sipas hulumtimit, informimi i mediave ishte kryesisht i njëanshëm, informacionet dhe deklaratat u plasuan në mënyrë selektive dhe të njëanshme, me shumë prej

narrativëve u minua besimi në institucione dhe u nxitën ndarjet ndëretnike dhe ndarjet e tjera në shoqëri. Hulumtimi tregoi gjithashtu se mediat ishin kryesisht transmetues të heshtur të mesazheve në fushatë, se përhapnin populizëm, madje edhe frikë dhe pasiguri te qytetarët, dhe në vend të argumenteve apo analizave të situatave, shpeshherë demonizonin personalitetet. Sipas hulumtimit, rreth 38 për qind e pjesëmarrësve të fushatës u paraqitën retorikisht si "shpëtimtarë të kombit", 33 për qind si mbështetës të BE-së, 22 për qind si mbrojtës të identitetit dhe 18 për qind si mbrojtës të drejtësisë - gjë që tregon se si ishte raporti i forcave për negociata të shpejta mes Maqedonisë dhe BE-së dhe sa fitoi slogani "Maqedonia krenare", i cili bashkoi ata që panë "diktat bullgar" në kornizën e negociatave.

Në ato dy slogane, në fakt, u bazua më së shumti fushata parazgjedhore e VMRO-DPMNE-së, e cila u vlerësua si ideologjike, etnike dhe jounifikuese lidhur me qëllimin strategjik të integrimit evropian. Mediat në raportim në masë të madhe e përvetësuan atë retorikë, me vetë faktin se theksi u vendos në deklaratat, e jo në premtimet parazgjedhore apo analiza të fushatës. Praktikisht, media ka qenë e mbushur me përmbajtje politike të servirura, me pak qasje kritike të pranishme ndaj asaj që u tha dhe u premtua në fushatë, siç e shohim për shembull në muajt e fundit të zgjedhjeve në SHBA, ku të gjitha deklaratat dhe pretendimet kalojnë përmes "fact-checking"-ut (verifikimit të fakteve) nga media, bile edhe gjatë vetë mbajtjes së debateve.

Çfarë flisnin VMRO-DPMNE dhe VLEN para fushatës, e çfarë pas saj?

Megjithatë, më e rëndësishmja është ajo që e thoshte dhe paralajmëronte VMRO-DPMNE-ja, e krahas tyre edhe VLEN-i si partner i mundshëm i koalicionit të ardhshëm, dhe ajo që ndodhi në njëqind ditët e para pas zgjedhjeve dhe formimit të qeverisë së re.

Në programin zgjedhor të VMRO-DPMNE-së "Platforma #1198", në kapitullin me titull "Patriotizmi që bashkon" thuhej se qëllim kyç i qeverisë së ardhshme do të jetë anëtarësimi i Maqedonisë në Bashkimin Evropian. Pas këtij përcaktimi të shkurtër pasonte një mori justifikimesh nëse do të ndodhë kjo, të cilat nuk e kanë vendin në një program politik që duhet të premtojë, e jo të parashikojë dhe të kërkojë alibi - nga ajo se ka ngecje në zgjerim, se rajoni është bërë shënjestër e ndikimeve të huaja dhe se në Evropë ka pasiguri politike. Më pas, negociatat kushtëzohen me respektimin e çështjes së gjuhës, identitetit kombëtar, respektimit të historisë dhe kulturës maqedonase, me paralajmërim se do të bëjnë "përpjekje maksimale për përparim real të dukshëm dhe për anëtarësim në baza të barabarta dhe reciproke" dhe sipas kritereve të matshme dhe objektive. Në ato korniza është paralajmëruar se qeveria e re do të ofrojë ndryshime kushtetuese me zbatim të vonuar si zgjidhje alternative për fillimin e negociatave, së bashku me kërkesën për garanci për identitetin maqedonas dhe reciprocitet të të drejtave dhe detyrimeve me Bullgarinë. Praktikisht, nga faza që nuk do të ketë ndryshime kushtetuese nën " diktatin bullgar", VMRO-DPMNE kaloi në fazën e ri-negocimit me Bullgarinë dhe pranimit të kushtëzuar të kornizës negociuese dhe kushteve të Këshillit Evropian, ndërsa mediat e transmetuan këtë në mënyrë mekanike, pa e aktualizuar dhe analizuar ndryshimin e qëndrimeve. Në vend të kësaj, tema ishte nëse korniza e negociatave mund të ndryshohej apo jo, kështu që u dhanë interpretime ligjore dhe politike. Më parë, retorikisht nga opozita e atëhershme, këto kushte në fushatë prezantoheshin si një "jo" kategorike për ndryshimet kushtetuese. " Përderisa unë jam kryeministër, nuk do të kalojë dhe nuk do të ketë ndryshime kushtetuese" , "Ndryshimet kushtetuese para hyrjes

në BE janë shantazh", "Siljanovska-Davkova: Nëse me ndryshimet kushtetuese bëhesh anëtare e BE, do të kishim qenë deri tani", "VMRO-DPMNE nuk pranon kushtëzimin me amendamentet kushtetuese", "Ndryshime kushtetuese nën diktatin bullgar nuk ka dhe nuk do të ketë (Nikolloski)", "Mickoski: Kovaçevski dhe Pendarovski punojnë për interesat e Bullgarisë" dhe ngjashëm - ishin titujt që dominuan lajmet në këtë periudhë.

Pritjet që ndryshimet kushtetuese si kusht për vazhdimin e negociatave me BE-në do të kthehen si temë e parë pas zgjedhjeve, gjegjësisht se do të kalohet nga retorika parazgjedhore në realitetin politik, megjithatë nuk u realizuan në njëqind ditët e para të qeverisë së re.

Në vend të kësaj, për të zbutur jehonën e "diktatit bullgar" dhe "jo"-në e prerë për ndryshimet kushtetuese, menjëherë pas zgjedhjeve në mënyrë të papritur u hap tema e zbatimit të Marrëveshjes së Prespës dhe emrit kushtetues të shtetit. Mirëpo, për dallim nga trajtimi i çështjeve kontestuese me Bullgarinë, kjo temë u prit me trajtim kritik dhe negativ, ku vlerësimi më i shpeshtë ishte se Maqedonia nuk ka nevojë për hapje shtesë të çështjeve të mbyllura, siç është kjo me Greqinë. Shpjegimet e presidentes Gordana Siljanovska Davkova dhe kryeministrit Hristijan Mickoski se si do ta zbatojnë Marrëveshjen e Prespës dhe kur do ta zbatojnë emrin kushtetues të shtetit ishte lajm kryesor për javë të tëra për mediat, të cilat raportuan rregullisht reagimet nga Athina dhe Brukseli. Kjo tregoi se te mediat është zhvilluar një ndjeshmëri për respektimin e asaj që nënshkruhet jashtë dhe për çështjet dypalëshe me Greqinë, përkundër qasjes ndaj çështjeve dhe mesazheve që vijnë nga Bullgaria. Megjithatë, ky episod tregoi se në çfarë mase mediat në vendin tonë ndjekin në mënyrë rutinore agjendën e qeverisë dhe partive politike dhe sa është e lidhur puna e tyre me ngjarjet e përditshme politike, pa marrë parasysh se sa ishin të vetëdijshëm se disa çështje dhe veprime shërbejnë vetëm për të shpërqendruar vëmendjen e opinionit publik nga çështje të tjera më të rëndësishme dhe thelbësore, për të forcuar rejtingun apo për të krijuar konfuzion rreth temave reale në opinionin publik.

Pasi u harxhua kjo temë, fokusi u kthye në çështjen reale të integrimeve evropiane – ndryshimet kushtetuese, por nuk u pasua me ashpërsinë, me të cilën u kërkua nga LSDM-ja të jepte llogari për atë që premtoi dhe nuk realizoi në lidhje me negociatat me BE-në. Për më tepër, rezulton se për mediat është temë vetëm nëse integrimi evropian dështon e jo se si ai të ketë sukses, e llogari kërkohet vetëm nga ata që përpiqen të shtyjnë përpara agjendën evropiane, ndërsa mungojnë pyetjet se sa kohë do të zgjasë kjo dhe sa do t'i kushtojnë vendit porositë e qeverisë së re se do të presin (Mickoski: "Ndryshimet kushtetuese me efekt të vonuar janë një nga zgjidhjet e mundshme, me kusht që të kemi një garanci të qartë për anëtarësim në BE " dhe Mucunski: " Ne jemi të gatshëm të pranojmë ndryshime kushtetuese me aplikim të vonuar, kështu do të kemi garanci se nuk do të ketë kushte të reja nga Bullgaria"). Pra, teknikisht transmetohen deklaratat e zyrtarëve të lartë se do të negociojmë me Bullgarinë kur të ketë një qeveri politike të qëndrueshme (edhe pse nuk pati sukses gjashtë herë deri më tani) dhe se pa aplikim të vonuar nuk do të ketë ndryshime kushtetuese, që do të thotë se nuk do të ketë vazhdim të negociatave me BE-në, nuk do të ketë as mjete nga Plani i Rritjes dhe nuk do të ketë nevojë për zbatimin e reformave të kërkuara nga Brukseli.

Pa reagim kaloi edhe vlerësimi i shefit të diplomacisë, Timço Mucunski se nuk ka garanci për sukses lidhur me përpjekjet për të ndryshuar kornizën e negociatave dhe konkluzionet për Maqedoninë nga BE-ja dhe se ai është i vetëdijshëm se janë të vogla gjasat për të bindur Bullgarinë që të mbështesë zbatimin e vonuar të ndryshimeve

kushtetuese, që praktikisht do të thotë të dështojnë negociatat për një marrëveshje të re dhe të hiqet dorë nga integrimi evropian.

Ashtu si VMRO-DPMNE-ja, edhe VLEN-i fliste një gjë para zgjedhjeve, e tjetër gjë pas tyre, por kthesa e tillë vetëm konstatohet përmes titujve në media, pa u analizuar më hollësisht. Kështu, në qershor të vitit 2024, lideri i Alternativës, Afrim Gashi deklaroi se nuk e di vallë kanë premtuar një datë të saktë për ndryshimet kushtetuese për të vazhduar negociatat me BE-në, e më pas se "nuk janë këtu (në pushtet) për të dalë (nëse nuk ka ndryshime kushtetuese) por për të ndërtuar institucionet". Për më tepër, ai i kushtëzoi ndryshimet e kushtëzuara me marrjen e garancive nga BE-ja, duke marrë përsipër retorikën e VMRO-DPMNE-së.

Bilall Kasami nga BESA, po ashtu para zgjedhjeve pohonte se pa ndryshime kushtetuese nuk do të ketë koalicion, gjegjësisht se ky do të ishte kusht që ata të hynin në koalicion qeveritar me VMRO-DPMNE-në, e tani pas zgjedhjeve ngushëllon se me ta (VLEN-in) dhe me VMRO-DPMNE-në ndryshimet kushtetuese do të kalojnë shumë më lehtë se sa të ishin në pushtet ata që i shtynin, por nuk thotë se kur.

Arben Taravari ishte më optimisti për ndryshimet kushtetuese, duke deklaruar se "beson se deri në vitin 2028 mund të jemi pjesë e BE-së", ndërsa ministri i ri i Çështjeve Evropiane Orhan Murtezani veçmë po promovon qëndrimet e VMRO-DPMNE-së se "ndryshimet kushtetuese me efekt të shtyrë do të ishin një garanci se nuk do të ketë bllokada të reja dhe se Korniza e negociatave nuk do të ndryshojë". Taravari tha gjithashtu se "nuk ka alternativë tjetër për rrugën evropiane, përveç ndryshimeve kushtetuese" dhe u jepte afat prej 6 muajsh, ndërsa Gashi tani thotë se "do të ketë ndryshime kushtetuese kur të marrim garanci nga BE-ja" për identitetin maqedonas. E fundit është se VLEN nuk do të insistojë me çdo kusht për ndryshime kushtetuese dhe se gjashtë muaj kanë qenë afat për të formuar qeverinë, e jo për të miratuar ndryshimet në Kushtetutë. Kryeministri më në fund e mbylli këtë temë me titullin: "Mickoski nuk e pranon kushtin nga VLEN – ndryshimet kushtetuese për koalicion".

Pasi, me sa duket, edhe kjo nuk mjaftoi për të zvetënuar temën e integrimeve evropiane, ndodhi vizita e Presidentes Siljanovska- Davkova në Bullgari dhe skandali me mosvendosjen e flamurit kombëtar, që u bë shkak për shpërthime të sulmeve jodiplomatike nga të dyja anët e kufirit, për notë proteste, kërkesa për dorëheqje dhe për folklor të ngjashëm politik që u mbulua gjerësisht nga mediat e vendit. Në këtë kontekst ishin edhe paralajmërimet për ndalimin e ndërtimit të Korridorit 8 që provokuan shumë tituj, por vetëm një dalje në terren për të raportuar për situatën reale rreth këtij aksi rrugor, për dallim nga disa tekste analitike përplot fakte nga mediat në Bullgari për këtë temë. Ky lexim paralel i raportimit të mediave maqedonase dhe bullgare tregoi se sa në mënyrë jokritike, sipërfaqësore dhe politike ndiqen temat kryesore nga mediat tona dhe sa kjo gjë e turbullon pasqyrën reale tek qytetarët, të cilët i profilizojnë qëndrimet e tyre në bazë të raporteve mediatike dhe pretendimeve të partive politike.

Këtu shtrohet pyetja - vallë mund të shtyjnë media të tilla agjendën evropiane të Maqedonisë dhe a e bëjnë fare atë, edhe pse të gjitha sondazhet tregojnë se qytetarët ende në përqindje më të madhe dëshirojnë që vendi të bëhet anëtar i BE-së dhe se aty e shohin të ardhmen, sado që dyshojnë nëse do të arrihet sukses në këtë.

Euro-skepticizëm, ngopje apo dëshpërim mediatik?

Paralelisht me faktin se partitë politike që ishin avokuesit më të mëdhenj të integrimeve evropiane, përveç BDI-së, nuk fituan besim në zgjedhje dhe humbën pushtetin, u dobësua edhe "zëri" i të ashtuquajturave media pro-evropiane apo pro -liberale. Ato, për shkak të aktrimit në vend të bërjes së reformave nga qeveria e kaluar, veçanërisht lidhur me sundimin e ligjit, si dhe për shkak të politikës së BE-së në raport me vetot ndaj Maqedonisë, humbën argumentet para opinionit për ta shtyrë këtë temë.

Si pasojë e një atmosfere të tillë, gjithnjë e më shumë publikohen informacione me konotacion negativ për BE-në, ku vendi ynë paraqitet si viktimë, integrimi ynë evropian si i "përhershëm", procesi si "nënçmim", si "i padrejtë dhe joparimor", e Brukseli si hipokrit, me standarde të dyfishta dhe qëllime të pandershme ndaj Maqedonisë. Disa nga këto tone merren nga propaganda serbe kundër BE-së, e cila është gjithnjë e më e pranishme në vendin tonë, nga mediat e financuara nga burime hungareze, por edhe nga manipulimet e politikanëve vendas që në këtë mënyrë luajnë në kartën e nacionalizmit dhe padrejtësisë të përhershme ndaj Maqedonisë. Lajmet janë në favor të asaj se zgjerimi i BE-së është i pasigurt, e deri te ajo se të gjithë na kanë kapërcyer për shkak të politikës joparimore të BE-së, e jo sepse Maqedonia nuk i ka përmbushur kushtet. Fitohet përshtypja se vetëm vendi ynë kushtëzohet nga Bashkimi Evropian, megjithëse në Kornizën negociuese për Serbinë ka një kapitull të tërë për Kosovën, ka kushte të vështira edhe në atë të Shqipërisë, e gjithashtu i kushtëzuar është edhe pranimi i Ukrainës – vetëm në territoret që do të sundojë në atë moment, që do të thotë eventualisht pa Donbasin dhe Krimenë. Dhe kështu, u shfaqën tituj se "Edhe Bosnja na kaloi", se "Fillimi i negociatave me Ukrainën ngre çështjen e diskriminimit ndaj Ballkanit Perëndimor", se BE-ja solli "Dritë jeshile për Kievin, por zhgënjim për Maqedoninë e Veriut", se "kapitujt 34 dhe 35 u zhdukën nga negociatat me Maqedoninë" (që do të thotë se nuk do të kemi komisar evropian, status të barabartë si anëtar dhe gjuhën maqedonase si zyrtare në BE), se "ETIAS do të hyjë në fuqi më shpejt se liberalizimi i vizave" (edhe pse procesi po përgatitet për më shumë se pesë vjet) dhe të ngjashme.

Shumë nga raportimet i referoheshin edhe sjelljes së LSDM-së ndaj negociatave me BE-në si drejtim i një "politike të jashtme lëshuese dhe denigruese", të cilën portali "Lider" e cilësoi si "Përralla e Kovaçevskit" në të cilën "negociatat me BE-në janë një mit, ndërsa korrupsioni është ligj". Gjatë marrjes së vendimit për Ukrainën, "pirja e kafesë së Orbanit" u shfrytëzua gjerësisht si provë se, kur dëshiron BE-ja, mund të parandalojë veton nga një shtet anëtar, edhe pse Budapesti nuk ishte i prekur drejtpërsëdrejti nga kjo. Thelbi i këtyre narrativave mediatike është se politika e BE-së shkakton vetëm turp dhe nënçmim për Maqedoninë, se vendi do të jetë një kandidat i përjetshëm dhe se do të mbetet në dhomën e pritjes së BE-së, gjë që ilustrohet përmes një titulli më frymëzues, i cili thoshte: "Kush fitoi negociatat me Unionin: Bosnja e cila është protektorat, Ukraina e cila është në luftë dhe Moldavia e cila nuk ka territor të përcaktuar", e që më pas një tjetër media të konkludojë se "Ukraina dhe Moldavia po hyjnë në negociata, e Maqedonia në agoni".

Paralelisht me këtë dëshpërim mediatik dhe "kalimero - pozitë", u dramatizua edhe mundësia e kërkesave të reja në procesin e negociatave dhe u insistua në garanci se nuk do të ketë kushte të mëtejshme, gjë që nuk ka fare logjikë në lidhje me mënyrën se si zhvillohen negociatat me BE-në. Raportimi i tillë krijoi një opinion publik në vend, sipas të cilit BE-ja është ajo që duhet të na japë garanci, e jo ne të përmbushim kushtet, ndërsa

ata politikanë që do të dalin dhe premtojnë se do të punojnë për negociatat, duhet të shpallin veten paraprakisht si humbës, sepse pritjet e procesit janë bërë shumë joreale.

Organizatat joqeveritare analizojnë, mediat tregojnë pak interesim

Se tema e integrimeve evropiane në media po zbehet, e dëshmojnë edhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të fokusuara në këtë proces, numri i të cilave është gjithashtu në rënie, ndërsa tani po punohet për aspekte më tërheqëse të tij, për të mbajtur gjallë interesimin. Andreja Stojkovski nga Instituti Prespa vlerëson se mediat nuk e përcjellin temën në thelb, se po "ndjekin sensacione, klikime dhe pëlqime", dhe se tema e integrimeve evropiane nuk është më "e gjallë" sepse nuk ua sjell atyre këtë. Sipas tij, shumë pak është shkruar për ndryshimet kushtetuese pas zgjedhjeve dhe askush nuk e shtron dilemën se pse duhet të negociojmë me Bullgarinë, kur bashkëbiseduesi ynë në anën tjetër është Bashkimi Evropian. Mediat, vlerëson ai, në raportim e ndjekin kryesisht agjendën e koalicionit qeverisës, sepse qendrat e tyre për informim i joshin në mënyrë të përsosur te temat që u nevojiten.

"Të gjithë e ndjekim tregimin e tyre, po kthehemi në kohërat e disa viteve më parë", vlerëson Stojkovski për këtë analizë. Sipas tij, tema e integrimeve evropiane është zbehur në opinion dhe në media, sepse si në kohën e LSDM-së, ashtu edhe tani, është reduktuar në një narrativë të thjeshtë, gjegjësisht retorikë të zhveshur që nuk pasohet me reforma dhe vendime të nevojshme. Diskursi në opinionin publik gjatë muajve të kaluar, vlerëson ai, ka qenë rreth frazës kush është për BE-në e kush jo, por në praktikë nuk ka pasur zhvendosje, gjë që e ka bërë temën jo tërheqëse për opinionin publik, pra edhe për mediat. Faktin që nuk ka momente të reja në proces, ai e vuri në dukje si arsye kryesore për interesimin e ulët të gazetarëve për të raportuar në mënyrë më përmbajtjesore për procesin.

"Nëse nuk ofrojmë diçka të re dhe nuk fitojmë një kornizë të re negociuese apo kushte të reja, ne po shkojmë drejt boshtit të vendeve, në të cilat po forcohet bezdisja dhe ngopja me BE-në, si Serbia dhe Hungaria", thotë Stojkovski. Sipas tij, në vend veçmë ekziston një rrjet i mediave euroskeptike, në raportimin e të cilave mund të dallohet edhe një narrativë serioze ideologjike.

Simonida Kacarska nga Instituti i Politikave Evropiane (EPI) vlerëson se raportimet mediatike kushtuar integrimit evropian janë të fokusuara kryesisht në procesin formal, në procedura, në takime dhe raporte të rëndësishme të BE-së, ndërsa ka pak interesim për politikat sektoriale të Unionit, gjë që sipas saj është një mangësi. Një interesim të madh për BE-në ajo ka vërejtur në vitin e kaluar pas publikimit të raportit për progresin e Maqedonisë në nëntor (për shkak të vlerësimit për ngecje serioze në reformat e sundimit të ligjit), por ky interesim mungoi kur u botua raporti për klasterin "Fundamentet", për të cilin opinioni publik mësoi disa ditë më vonë përmes rrjeteve sociale, megjithëse përmbante rekomandime për fushat kryesore të negociatave. EPI është një nga organizatat e pakta joqeveritare të mbetura (përveç IDSCS, Lëvizja Evropiane, Unioni Pan-Evropian, Instituti Prespa, Eurothink ...) që e ndjek procesin e integrimit evropian në mënyrë kritike dhe informative, publikon rregullisht raporte për përparimin lidhur me sundimin e ligjit dhe organizon debate për drejtimet e politikës sonë të jashtme, mirëpo përshtypja e Kacarskës është se vëmendja e opinionit publik për këtë temë është në rënie.

Marko Troshanovski nga Instituti për Demokraci "Societas civilis" gjithashtu vlerëson se para zgjedhjeve dhe gjatë fushatës është raportuar shumë për "propozimin francez", marrëveshjen me Bullgarinë dhe ndryshimet kushtetuese, por tema e integrimit evropian është zhdukur nga media pas zgjedhjeve dhe disi është zbehur në opinion. Shkak për këtë, sipas tij, është njoftimi se do të ri-negociohen kushtet e negociatave dhe se pritet një qeveri e qëndrueshme në Bullgari që procesi i gjetjes së zgjidhjes të vazhdojë. Por ai gjithashtu beson se në muajt e kaluar, megjithëse ka gazetarë të specializuar për integrimin evropian, fokusi ishte ende në një nivel shumë sipërfaqësor, pjesërisht për shkak të zgjedhjeve dhe pjesërisht për shkak se asgjë e re nuk po ndodh në këtë front, sepse shteti po qëndron në vend në lidhje me integrimin në BE. Përshtypja është, thotë ai, se anëtarësimi ynë në BE është ndalur me përfundimin e skriningut dhe, në këtë *limbo*, e cila është pjesërisht e justifikuar, ka rënë interesimi i opinionit për këtë temë, prandaj edhe trajtohet në nivel jo-thelbësor dhe vetëm si retorikë parazgjedhore dhe paszgjedhore për reforma kushtetuese e të ngjashme. Ai nuk sheh euroskepticizëm në raportimet apo ndarje të tyre në pro-BE apo anti-BE, por vëren se është rritur ndikimi i mediave të financuara nga burime hungareze dhe ndikimi i "botës serbe", duke ribotuar përmbajtje nga mediat atje.

"Mediat që mbajnë anën e integrimit evropian e kanë të vështirë ta legjitimojnë, arsyetojnë dhe aktualizojnë temën, tani që kemi ngecur në proces dhe kur qytetarët janë ngopur me kushtëzimet dhe përvojën e hidhur", vlerëson Troshanovski .

Sipas tij, tani opinioni publik në Ballkan është kryesisht në kornizën se "nuk na duan në BE" dhe "nuk do të hyjmë kurrë në anëtarësi", e një qasje e tillë nuk është zgjidhje nëse ky është qëllim strategjik për vendin. Megjithatë, ai theksoi se në anketën e fundit të IDSCS për punën e Kuvendit në vitin e kaluar, si çështje kyçe që kanë ndjekur krahas debatit për buxhetin dhe lojërat e fatit, qytetarët kanë theksuar edhe debatet për çështjen e integrimit evropian, që sipas tij do të thotë se ka ende një ndjeshmëri ndaj temës, edhe pse ndoshta kjo ndiqet me inerci. Interesimi për të raportuar për këtë temë, sipas Troshanovskit , në të ardhmen do të varet nga ndikimi i aksit Serbi-Hungari-Bullgari, por edhe nga ajo se sa real është momentumi i ri për zgjerim, sepse përshtypja e tij është se momentumi që ishte krijuar pas luftës me Ukrainën tashmë është zhdukur, kështu që fotografia nuk është bardh e zi dhe nuk varet vetëm nga zhvillimet e brendshme.

Edhe Biljana Petkovska nga Instituti Maqedonas për Media konsideron se tema e integrimeve evropiane ishte më pak e pranishme në media në periudhën e fundit për shkak të zgjedhjeve, si në vendin tonë ashtu edhe në Bashkimin Evropian, por se ardhja e një komisari të ri evropian për zgjerim, qeverisë së re në vendin tonë dhe ambasadorit të ri të BE-së në Shkup, do të japin një impuls të ri. Sipas saj, pasi koalicioni aktual qeveritar premtoi se do të punojë për ndryshimin e kushteve, ka pak informacion se çfarë po bëhet konkretisht në atë plan, ndërsa raportimet në media janë të kufizuara në atë që thotë kryeministri Mickoski apo zyrtarë të tjerë. Ndonëse, sipas vlerësimit të saj, në fushatën zgjedhore kishte njëfarë presioni mediatik lidhur me ndryshimet kushtetuese, kjo ka munguar më pas, e po forcohet përshtypja se askush nuk beson më në perspektivën evropiane të vendit. Sipas Petkovskës, mediat tani kryesisht e ndjekin interesin e qeverisë e jo të qytetarëve, andaj vlerëson se ato duhet të jenë proaktive, sepse qeveria nuk dëshiron që kjo temë të jetë në fokus. Në fund, thotë ajo, energjia që dërgon Brukseli ndaj Maqedonisë nuk është në favor të nxitjes së entuziazmit për integrime evropiane.

Dragan Sekullovski nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë thotë se kjo temë është aktuale në valë, dhe se në përgjithësi për të raportohet pas ngjarjeve apo deklaratave të caktuara. Nuk ka konsistencë në raportimet për atë se çfarë përmbush shteti si kusht për BE-në, thotë ai, ndërsa numri i gazetarëve që e ndjekin këtë çështje është në rënie, sikur edhe qëndrimet e tyre në Bruksel. Në përmbledhje, thotë Sekullovski, ka një grup të vogël gazetarësh që ndjekin politikën e jashtme dhe shkruajnë për BE-në, ndërsa mediat nuk kanë staf të mjaftueshëm dhe raportojnë për gjithçka dhe për çdo gjë, kështu që mungon kapaciteti për raportim më analitik dhe më kritik. Në përgjithësi, edhe Sekullovski vëren se në masë të madhe ndiqen agjendat e partive, e në mesin e tyre "rrallëkush është objektiv", gjë që pasqyrohet edhe në raportime. Nën ndikimin e proceseve të rrënuara integruese nga vetot e fqinjëve dhe nën ndikimin e raportimit në rajon, në media shfaqet edhe euroskepticizmi, por sipas tij, ai nuk është i bazuar ideologjikisht, por më tepër është një refleks ndaj gjendjes, andaj është disi i justifikuar dhe objektiv, sepse edhe BE-ja dështoi politikisht në raport me Maqedoninë.

Konkluzione dhe zgjidhje të mundshme

Nga analiza rezulton se zgjerimi i BE-së, e në këtë kuadër edhe integrimi evropian i vendit tonë si temë, përjetuan një lloj "anijembytjeje" pas zgjedhjeve dhe shtyhen si tema në margjina me vetëdije. Mediat para, gjatë dhe pas zgjedhjeve kanë raportuar kryesisht për aspekte që ua kanë imponuar partitë politike, pa i analizuar në mënyrë kritike politikat e tyre për këtë çështje, pra çfarë kanë thënë para zgjedhjeve, çfarë kanë premtuar gjatë zgjedhjeve dhe çfarë po realizojnë tani, duke pasur parasysh mbi të gjitha interesin e qytetarëve.

Tema e integrimit evropian, po të ndiqni rrjedhën e ngjarjeve dhe tonin e titujve të 12 muajve të fundit, është përdorur dhe keqpërdorur për qëllime politike, si mënyrë për të rënë dhe për të ardhur në pushtet, në vend se për të kërkuar zgjidhje. Ajo ishte një mënyrë, përmes përdorimit të të ashtuquajturit "diktat bullgar", për të kërkuar zgjedhje dhe për të rrëzuar rejtingun e qeverisë së mëparshme, për të polarizuar elektoratin përmes retorikës "për BE" dhe "kundër BE", si dhe për të rikompozuar koalicionin aktual qeveritar përmes kërcënimeve se nuk do të ketë ndryshime kushtetuese nën kushtëzimin bullgar. Ndërsa tani, pas zgjedhjeve, "jo"-ja kategorike për ndryshimet kushtetuese u shndërrua në paralajmërim për pranimin e atij kushti, nëse ndryshimet kushtetuese shtyhen deri në përfundimin e negociatave me BE-në, përmes ri-negocimit , por vetëm me një qeveri të re të qëndrueshme dhe politike të Bullgarisë. Mediat, sipas të gjitha vlerësimeve, kanë qenë vetëm transmetues pasiv të deklaratave dhe premtimeve të partive politike dhe nuk kanë pasur analizë thelbësore dhe qasje kritike gjatë fushatës, e nuk kanë as tani pas zgjedhjeve.

Ka qenë i ulët edhe interesimi për ndryshimet në BE lidhur me zgjedhjet evropiane, e rrjedhimisht edhe për shanset e integrimit evropian (nuk është e parëndësishme se kush do ta udhëheqë BE-në dhe cilat parti do ta dominojnë atë), mirëpo janë përdorur vendimet e Brukselit gjatë kësaj periudhe për ta përhapur ndjenjën e padrejtësisë dhe kushteve të padrejta ndaj Maqedonisë. Krahas njoftimeve të fundit për ndarjen e rrugës për qasje të vendit në BE nga Shqipëria, kjo i referohet mbi të gjitha raportimit mediatik pas vendimit për fillimin e negociatave me Ukrainën, i cili nuk u shpjegua në mënyrë kritike për publikun. Në përgjithësi, për zgjerimin e BE-së shkruhet më shumë dhe më

gjerësisht në mediat e huaja se sa në ato vendase, ndërsa organizatat joqeveritare e trajtojnë këtë temë në mënyrë më substanciale dhe më të thellë se sa gazetarët.

Duke pasur parasysh vlerësimin e përgjithshëm se është e vështirë të rikthehet besimi i publikut në proces, fokusi i mediave dhe organizatave joqeveritare tani po vendoset në disa sektorë, në të cilët miratimi i standardeve të BE-së konsiderohet vendimtar nga opinioni publik, si p.sh. lufta kundër korrupsionit, sundimi e ligjit, mbrojtja e mjedisit dhe të ngjashme. Më drejtpërdrejt, pjesa më e madhe e fondeve evropiane drejtohet në dy temat të para, e fokusi vendoset edhe në trajnimin e gazetarëve që ndjekin procesin e integrimit evropian dhe në rritjen e profesionalizmit në media, në vend të financimit të programeve dhe emisioneve mediatike që janë të fokusuara drejtpërdrejt mbi integrimin evropian si temë.

SHGM, me mbështetjen e BE-së, tashmë është duke themeluar një akademi për punonjësit e medias, përmes së cilës do të ofrojë trajnime tematike, por edhe "mjete" elektronike, gjegjësisht resurse që do të rrisin profesionalizmin dhe ekspertizën e tyre në katër drejtime, një prej të cilëve është integrimi evropian. Synimi është që kjo akademi të shndërrohet në një institucion të pavarur që do të trajnojë gazetarë të ardhshëm, sepse edhe mediat më të mëdha në vend nuk kanë qendra trajnimi për staf të ri. Ideja është që kjo akademi të funksionojë deri në fund të vitit duke ndjekur shembullin e asaj që po bëjnë fondacionet e mëdha mediatike nga jashtë, si ai i Reuters e Thomson, dhe do të përfaqësojë një kombinim të trajnimeve praktike dhe kurseve onlajn.

Paralelisht, me fonde evropiane punon edhe Eurothink, organizatë joqeveritare që shpalli konkurs për mentorë për trajnim të gazetarëve për çështjet e BE-së, i cili do të zhvillohet për herë të dytë përmes mësimdhënies në grupe. Një projekt me para evropiane realizohet edhe nga shërbimi publik RTMV së bashku me Agjencinë për Media dhe Shërbime Mediatike Audiovizuele AShMA, përmes të cilit, me trajnime të zhvilluara që nga qershori i kaluar nga ekspertë gjermanë, bëhet përpjekje për të forcuar profesionalizmin e shërbimit publik.

Disa organizata joqeveritare në vend, në kuadër të aktiviteteve të tyre, kanë organizuar qëndrime studimore për gazetarët në institucionet e Brukselit, sepse mediat nuk mund ta bëjnë vetë për shkak të burimeve të kufizuara, e kështu largohen nga burimet dhe temat në institucionet e BE. Qëllimi është të ofrohen njohuri më të mëdha rreth procesit, kontakte më të mira me institucionet e BE-së, më shumë njohuri për punën e tyre dhe një qasje më profesionale në raportim.

Por, pa ndryshuar raporti i faktorëve politikë në vend ndaj procesit të BE-së, pa u bashkuar partitë politike rreth tij në vend se ta përdorin atë për kalkulime politike, dhe pa pasur media që ndjekin interesat e qytetarëve në vend të interesave të politikanëve, rezultatet mediatike do të jenë njësoj si tani, e ndoshta edhe më keq. Dhe, mediat do të vazhdojnë të kyçen në garë për klikime në vend të garës me tema, si dhe në garë me rrjetet sociale, të cilat janë bërë mjete kryesore të propagandës.

(Autorja është redaktore e politikës së jashtme në "Nezavisen" dhe ish-korrespondente nga Brukseli)

2. POLITIKA MBI EUROINTEGRIMET NË MEDIAT SHQIPE: NGA KUSHTËZIMI DERI TE VENDNUMËRIMI

Shkruan: SEFER TAHIRI

Si u raportua në mediat në gjuhën shqipe mbi procesin e integrimit të Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, që nga miratimi i "propozimit francez" si kornizë për vazhdimin e negociatave për anëtarësim? Si u reflektua ky proces në diskursin politik dhe partiak gjatë fushatës zgjedhore? Cili kusht dhe afat iu dha palës qeveritare maqedonase nga partitë shqiptare të koalicionit VLEN lidhur me ndryshimet kushtetuese? A përmendet nga pala shqiptare ky afat pas zgjedhjeve? Si u raportua lidhur me "propozimin plotësues francez" që pala qeveritare ia ofroi BE-së? Si u interpretua deklarata e Aleksandar Nikollovskit, ministër në Qeverinë e Mickoskit, mbi integrimin e Shqipërisë? Si u raportua për shkëputjen e Shqipërisë nga Maqedonia e Veriut në rrugëtimin drejt BE–së?

Mediat në gjuhën shqipe, që nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë pasur një qasje më proaktive ndaj procesit të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian, për dallim nga ato maqedonase. Kjo ndërlidhet me faktin që në mediat shqipe ka dominuar diskursi publik dhe politik, i cili ka qenë më i distancuar, më neutral dhe më i "ftohtë" sa i përket impaktit të procesit të integrimit në BE dhe negociatave, që janë shoqëruar me zgjidhjen e çështjeve dypalëshe me Greqinë dhe Bullgarinë lidhur me emrin e shtetit dhe strumbullarin identitar të popullit maqedonas.

Në këtë kontekst, analiza trajton disa aspekte të raportimit të mediave në gjuhën shqipe mbi rrjedhën e integrimeve evropiane pas miratimit të "propozimit francez", përfshirë periudhën para dhe pas zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale dhe formimit të qeverisë së re në vend, kur çështja e ndryshimeve kushtetuese si kusht për vazhdim të negociatave me BE-në ishte në fokus të opinionit. Përveç trajtimit mediatik të qëndrimeve dhe veprimeve të përfaqësuesve të lartë të qeverisë së re dhe partive në pushtet përballë oponentëve politik, trajtesë e veçantë i kushtohet edhe raportimit mediatik lidhur me vendimin e Brukselit për shkëputjen e Shqipërisë nga Maqedonia e Veriut në rrugëtimin drejt BE–së dhe reflektimin e këtij vendimi te opinioni dhe qytetarët të vendit.

Histori e shkurtër e raportimit mbi "propozimin francez" dhe ndryshimet e propozuara kushtetuese

Siç është cekur në analizat e botuara nga IMA, në vitin 2022 hapësirën informative në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut, por edhe atë rajonale, e kanë dominuar raportimet me konotacione pozitive mbi "propozimin francez". Ndërsa, kritikëve të tij u është dhënë hapësirë e paktë dhe, këtu, kemi parasysh qëndrimet zyrtare të partisë opozitare (të mëparshme) VMRO –DPMNE. Shumë më pak hapësirë i është dhënë partisë "E Majta" (Levica), për shkak të qëndrimeve të saj të vazhdueshme antishqiptare dhe kundër Kosovës, por edhe për shkak të qëndrimeve të saj konstante anti–evropiane dhe anti–NATO.

Një vit më vonë, mediat në gjuhën shqipe patën fokus të qartë dhe konstant afirmativ edhe mbi ndryshimet e propozuara kushtetuese, me të cilat edhe bullgarët bëhen pjesë e aktit më të lartë juridik të vendit.

Mediat shqipe: Ka apo s'ka dokument të partive shqiptare për ndryshimet kushtetuese?

Diskursin publik në kampin politik shqiptar para zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale, që u mbajtën më 24 prill dhe 8 maj 2024 e dominoi debati mbi ndryshimet kushtetuese. Por ky diskurs nuk shquhet për qasje të thellë analitike dhe kontekstualizuese të integrimit, pasi më tepër është i bazuar tek deklarimet e kohëpaskohshme të politikanëve.

Prononcimet kryesisht janë bërë dhe bëhen për qëllime partiake dhe politike, duke mos shmangur as hipokrizinë apo demagogjinë e paketuar në formë të propagandës, meqë dy palët që janë tani brenda një qeverie adresojnë deklarime që janë diametralisht të kundërta. Pala shqiptare i kumton publikut shqiptar se ndryshimet kushtetuese do të ndodhin dhe nuk ka shmangie nga përcaktimi gjeostrategjik i vendit drejt BE. Ndërsa pala maqedonase deklarohet se nuk e ka ndërmend të bëjë kurrfarë kompromisi siç janë ndryshimet kushtetuese, që kryeministri dhe eksponentë të VMRO DPMNE–së i konsiderojnë si sakrifikim të qenies identitare të popullit maqedonas, edhe pse ky është kushti që të zhbllokohet procesi i integrimit.

Pjesa më e madhe e mediave shqipe edhe sa i përket integrimit në BE dëshmuan se janë nën ndikimin e madh të politikës, përkatësisht partive të proveniencave të ndryshme politike, pasi në vend që me vetënismë profesionale t'i ngrenë çështjet e rëndësishme që kanë interes publik, siç janë ndryshimet kushtetuese si kusht për integrimin e vendit në BE, mjaftohen duke e luajtur rolin instrumentalizues apo shërbyes, përkatësisht të «zëdhënësit» të politikës.

Reagime të mëdha në opinionin publik shkaktoi deklarata e kandidatit presidencial të koalicionit VLEN, Arben Taravari më 6 prill 2024 në debatin me kundër-kandidatin e Frontit Evropian, Bujar Osmani në TV 21, në të cilën pohoi se ka marrëveshje mes partive shqiptare, që të mos hyhet në qeverinë e re pa garanci për ndryshime kushtetuese.

"Për kushtëzimin për ndryshime kushtetuese, Taraari tregoi se ka marrëveshje xhentëlmenësh mes dy blloqeve. -Me siguri z. Ahmeti ju ka treguar, ne kemi një marrëveshje xhentëlmene, VLEN-i dhe BDI-ja. Që nuk shkojmë në një qeveri që nuk i bën ndryshimet kushtetuese, një marrëveshje xhentëlmenë", deklaroi Taravari në debatin në TV 21.

TV Alsat më 5 prill të vitit 2024 në kronikën me titull: "Fillimisht ndryshimet kushtetuese, pastaj Qeveria", raportoi se opozita e atëhershme shqiptare tërhiqet nga konstatimi se ekziston dokument i nënshkruar mbi ndryshimet kushtetuese, për dallim nga BDI-ja, e cila këmbëngulte në të njëjtën:

"Ka apo jo dokument të shkruar me të cilin partitë shqiptare në vend janë zotuar të kushtëzojnë përbërjen e Qeverisë me ndryshimet kushtetuese? Sipas BDI-së, një marrëveshje e tillë është nënshkruar para disa muajve nga disa parti, disa nga koalicioni qeveritar, të tjerët nga opozita. Opozita shqiptare thotë se dokument i tillë i shkruar

nuk ekziston. Fronti opozitar mbetet i mendimit se do të hyjë në koalicion qeveritar me partitë që mbështesin ndryshimet kushtetuese. Por, ata nuk theksuan se formimin e Qeverisë e kushtëzojnë me ndryshimin e Kushtetutës, duke lënë ndoshta të hapur mundësinë që kjo të ndodhë pas formimit të Qeverisë", raportoi TV Alsat.

Jehonë të madhe ka pasur edhe qëndrimi i nënkryetarit të atëhershëm të partisë Alternativa, Zeqirija Ibrahimi, i dhënë më 14 maj 2024 lidhur me dokumentin: "Zeqirija Ibrahimi e sfidon Frontin: Publikojeni letrën e nënshkruar, nëse e keni, ose kërkoni falje që mashtroni!".

Një pjesë e madhe e mediave raportuan edhe qëndrimet e ish kryeministrit Dimitar Kovaçevski dhe të liderit të atëhershëm të opozitës, Hristijan Micksoski.

"Lideri i LSDM-së, Kovaçevski, ka sqaruar se nuk është i njohur me një dokument të quajtur non-paper, i cili pretendohej të ketë nënshkruar marrëveshjen midis partive të bllokut shqiptar për mosformimin e koalicionit me parti të tjera pas zgjedhjeve që nuk pranojnë kërkesat e tyre...Nga ana tjetër, VMRO ka qëndruar kritike ndaj ndryshimeve kushtetuese, duke theksuar në veçanti shqetësimin për efektin e vonuar të amendamenteve. Lideri i tyre, Mickoski akuzoi se marrëveshja në Bullgari nuk ka mbrojtur gjuhën dhe identitetin maqedonas", raportuan mediat shqipe.

Mediat shqipe më 14 maj kanë raportuar edhe qëndrimin e përfaqësuesit të VMRO DPMNE-së, Stefan Andonovski, ndërsa titulli mbi këtë qëndrim ishte: "Taravari dha afat 6 muaj për Ndryshimet kushtetuese, Andonovski: VMRO nuk funksionon nën diktat, çështjet duhet diskutuar ndryshe".

Fokus mediatik mbi kushtëzimin politik të ndryshimeve kushtetuese

Mediat shqipe e kanë trajtuar në masë të madhe procesin e integrimit, por duke u fokusuar tek ndryshimet kushtetuese që kushtëzoheshin nga pala shqiptare, gjë që mund të thuhet se është edhe rezultat i ndikimit të etnocentrizmit ndaj përmbajtjeve mediatike.

TV 21 raportoi qëndrimin e kreut të Aleancës për Shqiptarët, Arben Taravari, i shprehur më 13 maj të vitit 2024 lidhur me afatin e miratimit të ndryshimeve kushtetuese. Ky televizion raportoi me titullin: "Nëse ndryshimet kushtetuese nuk bëhen për 6 muaj, do ta shqyrtojmë pjesëmarrjen në Qeveri".

"Ne na duheshin 10 vite VMRO dhe BDI, pa kushtëzime, pa asgjë, që të humbin 10 vite për t'u bërë pjesë e NATO-s. VLEN është garancë në Qeveri se me çdo kusht do të insistojë që sa më shpejt të fillojnë negociatat me Bashkimin Europian dhe të bëhen ndryshimet kushtetuese, se ai është kusht", citohet Taravari në raportin e TV 21.

Pas kësaj deklarate, tema e integrimit në mediat shqipe u zbeh në kuptimin e trajtimit mediatik në rrafshin informativ, ndërsa për atë analitik dhe hulumtues as që bëhet fjalë. Zbehje ka pasur edhe në trajtimin e kësaj teme në kolumna në gazeta apo portalet onlajn. Kjo qasje ndërlidhet edhe me faktin që media shqipe ishte e fokusuar tek negociatat për zgjedhjen e qeverisë, ndarjen e dikastereve dhe drejtorive, emrat e ministrave e zëvendësministrave e shumë informacione sipërfaqësore që nuk kanë interes publik,

pasi shpesh emrat raportoheshin pa bekgraundin e tyre profesional dhe të kompetencës për postet e marra.

Zbehje të intensitetit të raportimit mbi eurointegrimet ka pasur edhe pas formimit të qeverisë. Në skenën politike gjatë periudhës 100 ditore të qeverisë së re kanë dominuar çështjet e brendshme të ndjeshme politike që kanë shkaktuar përplasje etnike. Bëhet fjalë për përdorimin e gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare, heqjen e instrumentit të quajtur "balancuesi" për punësim në administratën shtetërore dhe publike, propozimi i koalicionit VLEN për Akademi shqiptare të shkencave dhe arteve dhe Ligjin e propozuar nga Lidhja Socialdemokrate për mbrojtësit e forcave të armatosura të vendit, që kanë luftuar në vitin 2001.

TV 21: Koalicioni VLEN tërhiqet nga gjashtëmujori kushtëzues

Ndonëse nuk kanë qenë konsistente sa duhet sa i përket raportimit dhe trajtimit analitik dhe interpretues mbi integrimin, mediat shqipe kanë ruajtur vazhdimësi në raportimin lidhur me afatet kushtëzuese mbi ndryshimet kushtetuese.

TV 21 më 9 gusht 2024 transmetoi kronikën, sipas të cilës koalicioni VLEN heq dorë nga afati kushtëzues për ndryshimet kushtetuese, me titull: "VLEN e zhvendos afatin për ndryshimet e kushtetuese – Në vend të 6 muajve, në afat të pacaktuar.".

"Koalicioni VLEN tërhiqet nga afati gjashtëmujor për vendosjen e Bullgarëve në Kushtetutë...Nga koalicioni disa herë theksuan se kanë dhënë afat prej 6 muajve, mirëpo nga ana tjetër kryeministri Hristijan Mickoski, thoshte se nuk punon me afate dhe ultimatume. VLEN tani e prolongoi afatin, por nuk dihet deri kur. Sipas tyre, fajin e ka Bullgaria. "Po të kishte qeveri funksionale në Bullgari, mendoj se tashmë do t'i kishim filluar negociatat për të arritur marrëveshje mes RMV-së dhe Bullgarisë. Duke pasur parasysh gjendjen në Republikën e Bullgarisë, mendoj se ka hapësirë këtu në koordinim me faktorin ndërkombëtar, që të shtyhet afati", tha Fari Iseni, zëdhënës i koalicionit VLEN", raportoi TV 21.

Pas deklaratës kushtëzuese të Taravarit, më 12 gusht 2024, TV 21 transmetoi kronikën, në të cilën edhe Taravari përgënjeshtron veten lidhur me ndryshimet kushtetuese, me titullin: "VLEN taktizon me afatin për ndryshimet kushtetuese – Taravari: Pas 6 muajve do të ulemi për të biseduar për ndryshimet".

"Koalicioni VLEN pas 6 muajve qeverisje sërish do të ulet për të biseduar për çështjen e ndryshimeve kushtetuese. Këtë e konfirmoi njëri prej liderëve të koalicionit, Arben Taravari. Ai në periudhën parazgjedhore thoshte se pas 6 muajve të mandatit, do ta rishqyrtojnë pjesëmarrjen e tyre në qeveri por tani nuk sqaroi nëse nga kjo çështje varet pjesëmarrja e tyre në koalicionin qeveritar", raportoi TV 21.

Mediat shqipe gjithashtu i dhanë hapësirë të konsiderueshme edhe deklaratës së liderit të Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela i cili është në emisionin Click plus të TV 21 është shprehur se "Kjo qeveri ka mbyllur kapitullin për eurointegrime dhe nuk e ka në plan këtë, as të bëj ndryshime kushtetuese". Ajo që është për t'u veçuar është fakti që kjo deklaratë kryesisht u transmetua në portale, por jo edhe në mediat tjera tradicionale. (Albazone, Top24, Infoshqip, TVNews).

Deklaratat e kryeministrit Mickoski për ndryshimet kushtetuese raportohen objektivisht

Edhe pse mediat shqipe shpesh kanë qasje etnocentrike kur trajtojnë çështjet e ndjeshme të shtetit, kur raportojnë mbi qëndrimet zyrtare të kryeministrit mbi temën e eurointegrimeve shquhen për objektivitet dhe saktësi, që janë parime themelore profesionale të gazetarisë.

Një pjesë e madhe e mediave shqipe i dhanë hapësirë të konsiderueshme deklaratës së liderit të VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickoski, më 2 shtator të vitit 2024, i cili si kryeministër pajtohet me votimin e ndryshimeve kushtetuese, të cilat do të hyjnë në fuqi vetëm atëherë kur vendi do të bëhet anëtar i BE: Titulli i mediave ishte "Mickoski: Ndryshimet kushtetuese me efekt të vonuar janë zgjidhje e mundshme, nëse ka garanci për anëtarësim në BE".

Kryeministri Hristijan Mickoski tha se si "shtet nuk mund të hyjmë në një proces naiv ku do të bëjmë vetëm lëshime pa pasur garanci të qartë se si shtet do të jemi pjesë e familjes evropiane". Ai tha se meqë askush nuk mund të garantojë asgjë, nuk do të jetë aq optimistë sa do të donte të ishte", raportuan mediat shqipe.

Para takimeve zyrtare të kryeministrit Mickoski me zyrtarët evropianë në Bruksel më 19 shtator 2024, TV Alsat në mënyrë objektive dhe korrekte transmetoi deklaratat e tij lidhur me të ardhmen evropiane të vendit. Titulli i këtij televizioni ishte: "Mickoski: Është e rëndësishme të dihet se kur do t'i përfundojmë negociatat".

"Nëse ngrihet tema e integrimeve evropiane, ai do të përcjellë frustrimet e popullit maqedonas. "Siç ishte në të kaluarën kur ishim opozitë, edhe tani si pushtet, tash kemi edhe më shumë argumente, duam t'i paraqesim ato, duam të përcjellim zhgënjimin e qytetarëve të Maqedonisë atje, sepse zhgënjimi është i madh, sepse më shumë se dy dekada e gjysmë pasi filluam rrugën tonë drejt Bashkimit Evropian, më shumë se një dekadë e gjysmë pasi morëm raportin e parë pozitiv nga Komisioni Evropian për fillimin e këtyre negociatave, ne nuk jemi në gjendje për të filluar. Jo sepse nuk respektojmë kriteret e Kopenhagës, jo sepse nuk jemi adhurues të vlerave evropiane, por sepse ka pengesa të imponuara artificialisht që asnjë komb apo shtet nuk i ka pasur, siç i kemi ne", tha Mickoski", raportoi TV Alsat.

Një pjesë e mediave shqipe deklaratën e Mickoskit e transmetuan me titullin: "Mickoski: Në Bruksel do të përcjell zhgënjimin e qytetarëve për rrugën e vendit drejt BE-së" (Inaonline, Lajmpress, Tetovasot, Telegrafi).

Ndërsa, TV Klan Maqedonia raportoi me titullin "Vizita e Mickoskit në Bruksel/ Mickoski: Në Bruksel do t'i mbrojë interesat e Maqedonisë". "Qytetarët të jenë të sigurt se do të luftojmë dhe arrijmë të mbrojmë interesat maqedonase", ka shtuar Mickoski, raportoi TV Klan Maqedonia.

Ajo që është për t'u nënvizuar është fakti se kur bëhet fjalë për raportimin mbi çështjet e integrimit në BE, pjesa më e madhe e mediave onlajn apo portalet bazohen tek televizionet nacionale komerciale, kryesisht tek TV Alsat ose televizionet kabllore nacionale, kryesisht tek TV 21, gjë që flet për kapacitete të vobekta profesionale të redaksive tjera.

Kjo ka ndodhur edhe ditën e vizitës së kryeministrit në Bruksel, në të cilën e prezantoi "propozimin plotësues francez", i cili synon që çështjet dypalëshe të mos jenë pjesë e negociatave me BE-në. TV Alsat raportoi me titullin "Mickoski: Më s'mund të pranojmë ultimatume, nëse ka vullnet, ka edhe mënyrë", ngjashëm siç kanë raportuar edhe shumë portale, gjë që vërtetohet nga portali për grumbullimin e lajmeve në gjuhën shqipe Fax.al.

Mediat shqipe me raportim korrekt për qëndrimet e Mickoskit lidhur me Komisionin Historik me Bullgarinë

Në mediat shqipe deklaratat e kryeministrit Mickoski kundër ish-anëtarëve të Komisionit për Çështje Historike dhe Arsimore me Bullgarinë janë publikuar në mënyrë korrekte dhe objektive. Deklarimet e kryeministrit e kanë aktualizuar në mediat shqipe punën e këtij komisioni. Derisa nuk pati përplasje mes kryeministrit dhe ish kreut të Komisionit, Dragi Gjorgjiev, raportimi mbi komisionin ka qenë tepër i zvetënuar, gjë që e dëshmon qasjen e një pjese të mediave shqipe se problemi me Bullgarinë në fakt trajtohet si problem etnik i maqedonasve.

Titulli i mediave shqipe më 12 shtator ishte "Mickoski akuzon anëtarët për tradhëti", ndërsa bazohej tek deklarata e kryeministrit:

"Le të përfshihet OSBE-ja, por organet e inspektimit dhe hetimit do të përfshihen tani për të parë se ku janë shpenzuar paratë. Dhe ata do të përfshihen për të parë se për çfarë janë shpenzuar paratë, sa janë paratë e atyre që nuk kanë bërë asgjë në vitet e kaluara, dmth kanë turpëruar popullin e Maqedonisë dhe kanë shitur interesat maqedonase" deklaronte Mickoski.

Sipas mediave shqipe, edhe më 26 gusht 2024 kryeministri Mickoski kishte adresuar kritika të ashpra në adresë të ish anëtarëve të komisionit. Titulli i mediave shqipe ishte "Mickoski: Komisioni i përbashkët maqedono-bullgar nuk ka qenë mbrojtës i interesave të RMV-së".

Jehona e deklaratës së Nikollovskit: Shqipëria nuk do të anëtarësohet në BE!

Një deklaratë, e cila ditëve të fundit ka shkaktuar jehonë të madhe, por negative në mediat e vendit, ka qenë ajo e ministrit të Transportit dhe Lidhjeve, Aleksandar Nikollovski, sipas të cilit Shqipëria asnjëherë nuk do të jetë pjesë e BE-së. Edhe pse kjo deklaratë pati konotacion negativ në opinion publik shqiptar, pasi u lexua si tendencë ndaj Shqipërisë, në fakt objektiviteti i kësaj deklarate është ndryshe nga interpretimi. "Unë deklaroj se Shqipëria kur nuk do të jetë anëtare e BE-së. Jo për shkak të Shqipërisë, por për shkak të qasjes së BE-së", ishte shprehur Nikollovski.

Hapësirë e konsiderueshme për shkëputjen e Shqipërisë nga Maqedonia e Veriut drejt BE-së

Vendimi i vendeve anëtare të BE që Shqipëria të ndahet nga Maqedonia dhe më 15 tetor në Luksemburg të nisë negociatat rreth kapitujve për anëtarësim në BE, ka marrë hapësirë të madhe në mediat shqipe. Arsyeja kryesore ndërlidhet me faktin se ky vendim e lë procesin e integrimit të Maqedonisë së Veriut në status-quo, që në fakt është lajm i keq për qytetarët e vendit. Sipas raportimeve mediatike, Maqedonia e Veriut ngel në vend për shkak të mosgatishmërisë së palës qeveritare të përfshijë bullgarët në Kushtetutë, ndërsa nënvizojnë se Shqipëria ec para në rrugëtimin integrues në krahasim me vendin tonë i cili me këtë vendim e konfirmon ngecjen në proces.

"Maqedonia e Veriut dështoi të bëjë një hap vendimtar drejt anëtarësimit në BE – Ndahet nga Shqipëria", është titulli i kronikës së TV Alsat, e botuar më 26 shtator 2024.

"Rruga e pranimit të Shqipërisë në BE do të shkëputet nga ajo e Maqedonisë së Veriut, me grupet e para të negociatave që do të hapen zyrtarisht për Tiranën më 15 tetor, sipas një vendimi unanim të ambasadorëve të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, shkruan Alsat. Hapi i radhës pritet të bëhet nga Shqipëria në mes të tetorit në kuadër të konferencës ndërqeveritare më hapjen e Kllasterit të Parë – Themeloret. Ky grup përfshin disa kapituj – Prokurimi, Statistikat, Gjyqësori dhe të drejtat themelore, drejtësia, liria dhe siguria dhe kontrolli financiar. Ky është një lajm i mirë për Shqipërinë në përpjekjet e saj për të përmbushur kërkesat për të avancuar në rrugën e saj në BE, por është një pengesë për Maqedoninë e Veriut, e cila edhe një herë dështoi të bëjë një hap vendimtar drejt anëtarësimit në BE", raportoi TV Alsat.

TV 21 raportoi me titullin "Shqipëria me dritë jeshile për në BE, po Maqedonia? Mickoski: Me diktate, jo, faleminderit", i cili ia bën me dije qartë publikut shqiptar diskursin dhe orientimin e qeverisë ndaj Evropës.

"Shqipëria merr dritë jeshile në rrugën drejt BE-së. Jozyrtarisht, konferenca e dytë ndërqeveritare në Tiranë u caktua për më 15 tetor, ndërsa Maqedonia mbetet në dhomën e pritjes. Kryeministri Hristijan Mickoski duke e komentuar gjendjen, thotë se "Nuk duhet më në llogari të lëshimeve nacionale dhe të identitetit, pa garanci, të pranojmë kushte. Sipas meje ky është diktat. Nëse ky është kushti që Maqedonia t'i vazhdojë negociatat, atëherë, e thashë edhe në Bruksel, jo, faleminderit", tha Hristijan Mickoski", raportoi TV 21.

Portali Inaonline në lajmin me titull «Ose bullgarët në Kushtetutë, ose mbyllet rruga evropiane, Shkupi të vendos?!"prezantoi qëndrimin e dy ish-kryeministrave të Bullgarisë, Bojko Borisov dhe Kiril Petkov, të cilët thanë se Marrëveshja e fqinjësisë së mirë duhet të respektohet. "Ata u bënë thirrje autoriteteve në Maqedoninë e Veriut që të vendosin nëse do t'i përfshijnë bullgarët në Kushtetutë apo nëse rruga e tyre drejt BE-së do të mbetet të mbyllura, raportoi INA**.**

Shumë media raportuan me titullin "Media bullgare: Shqipëria fillon bisedimet me BEnë më 15 tetor, ndahen rrugët me Maqedoninë e Veriut". Në fakt, lajmi për shkëputjen e Tiranës nga Shkupi u publikua nga Radioja Bullgare BNR, duke u thirrur në burime diplomatike.

Portali Zhurnal lidhur me këtë çështje ka publikuar edhe shkrimin me titull "Moment ideal për të vazhduar rrugën drejt BE-së", në të cilin ofron kontekstualizim historik bashkëkohor lidhur me kontestin me Sofjen:

"Ky kontest ka bllokuar procesin eurointegrues të vendit, me çka Bullgaria gjatë vitit 2021 i vendosi dy herë veto Maqedonisë së Veriut, njëherë në qershor, kurse më pas, më 14 dhjetor të vitit 2021, edhe një herë e bllokoi fillimin e negociatave RMV-BE. Edhe në vitin 2020, njëjtë vendi fqinj, i vendosi dy herë veto Maqedonisë së Veriut, një herë në këshillin e ministrave të Jashtëm të BE-së si dhe në Këshillin për Punë të Përgjithshme të BE-së, duke penguar në këtë mënyrë miratimin e kornizës negociuese për fillimin e negociatave të vendit me BE-në", raportoi Zhurnal.

TV Shenja raportoi me titullin "Konfirmohet 'ngelja' e Maqedonisë drejt BE-së, Mexhiti pret informacione zyrtare".

Ndër kolumnat e rralla që i kushtohet ndarjes së vendit nga Tirana dhe hapjes së kapitujve në negociatat me Shqipërinë është ajo e profesoreshës Besa Arifi me titull "Disa ecin para, të tjerët ngecin pas".

"Vendimi i BE-së përfaqëson një fitore për Shqipërinë dhe një moment kritik për Maqedoninë e Veriut. Ndërsa Shqipëria bën hapa të rëndësishëm përpara, Maqedonia e Veriut përballet me pasojat e mosveprimit politik, duke vonuar ambicien e saj të gjatë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian", shkruan Arifi në Portalb.

Në ditën e raportimit të lajmit për ndarjen e Shqipërisë, mediat shqipe raportuan se "100 mijë maqedonas kanë marrë nënshtetësinë bullgare".

Mediat shqipe me intonacion informativ kanë raportuar edhe mbi miratimin e Deklaratës së Parlamentit bullgar për të ndaluar fushatën anti-bullgare në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

"Parlamenti bullgar insiston në kthimin e dialogut pozitiv të ndërprerë nga RMV dhe ndalimin e fushatës antibullgare dhe deklaratave provokuese ndaj Bullgarisë në RMV. Deklarata konfirmon vullnetin e shtetit dhe institucioneve bullgare për organizimin e festimeve të përbashkëta të ngjarjeve dhe personaliteteve të përbashkëta historike, duke pasur parasysh historinë e pasur të përbashkët të dy vendeve. Asambleja Kombëtare gjithashtu nuk pajtohet fuqishëm me mohimin e historisë së përbashkët të RMV-së dhe Bullgarisë nga anëtarët e qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe beson se kjo është shkelje e drejtpërdrejtë e Traktatit të Miqësisë, Fqinjësisë së Mirë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Bullgarisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut nga viti 2017", raportuan mediat shqipe.

Siç vërehet nga raportimet dhe interpretimet, mediat shqipe kanë pasur qasje të balancuar ndaj aktorëve të përfshirë në çështjet që kanë të bëjnë me procesin e eurointegrimeve, pasi hapësirë i është dhënë zërave nga qeveria, por edhe opozita, edhe pse në tituj është vërejtur doza e zhgënjimit që vendi ngec.

Përfundime

Çështja e eurointegrimeve në mediat shqipe është zëvendësuar me debatin për ndryshimet kushtetuese, që kanë qenë kusht për integrim në BE. Kjo ka të bëjë edhe me faktin se në diskursin publik në gjuhën shqipe nevoja për miratimin e ndryshimeve kushtetuese është interpretuar si e domosdoshme.

Mediat në gjuhën shqipe janë vetëmjaftuar duke bërë gazetari raportuese sipërfaqësore, që nënkupton gazetari transmetuese të deklaratave lidhur me çështjet integruese, pa hyrë në analiza dhe interpretime. Ky fakt i përkufizon mediat si zgjatim i politikës, pasi ato kanë ngritur rrallë çështjet që janë me interes publik e që kanë ndërlidhje me integrimin.

Nuk ka pasur analiza se cili do të jetë ndikimi i mosvotimit të ndryshimeve kushtetuese ndaj stabilitetit të vendit në aspektin e sigurisë, ndaj rritjes ekonomike, ndaj reformave në administratën shtetërore dhe publike, luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, e në sektorë tjerë.

Nuk është trajtuar aspak çështja se çfarë do të ndodh me procesin e integrimit të vendit nëse nuk pranohet "propozimi plotësues francez" i përfaqësuesve të pushtetit dhe vallë qeveria ofron alternativë aleanciste ndërkombëtare nëse integrimi mbetet i bllokuar si rezultat i kushtëzimit nga pala bullgare.

Ajo që vërehet si trend dhe që nuk është i kohës së fundit është fakti që diskursin publik në ambientin mediatik në gjuhën shqipe për këtë temë e diktojnë mediat tradicionale përkatësisht televizionet nacionale, ndërsa në këtë drejtim prijnë TV Alsat dhe TV 21, nga të cilat portalet i kopjojnë lajmet dhe raportet mediatike. Në këtë mënyrë lulëzon gazetaria copy-paste, ndërsa një pjesë e njerëzve që punojnë në portale shndërrohen në shpërndarës të lajmeve.

Në mediat shqipe deklaratat e politikanëve maqedonas janë transmetuar në mënyrë objektive dhe korrekte, që zakonisht ndodh kur bëhen për tema të politikës së jashtme përkatësisht të integrimit. Por, duhet veçuar dominimin në diskursin mediatik të kryeministrit Hristijan Mickoski, që është rezultat i deklarimeve të tij të përditshme për tema e çështje të ndryshme, sidomos edhe rreth eurointegrimeve, ngjashëm siç ndodhte edhe me ish kryeministrin Zoran Zaev. Që nga formimi i qeverisë së re në komunikim politik të pushtetit ekzekutiv kemi monopol nga kryeministri, gjë që flet për tendenca të kontrollit ndaj "pushtetit të komunikimit", pasi shefi i qeverisë u përgjigjet mediave që nga çështje që kanë të bëjnë me politikën sociale deri tek ato gjeopolitike dhe gjeostrategjike. Paralelizmi etnik vërehet edhe në këtë drejtim, pasi zëvendëskryeministri i parë, Izet Mexhiti bën të njëjtën në komunikim me mediat shqipe. Të rrallë janë zyrtarët tjerë qeveritarë, të cilët deklarohen për mediat mbi çështje të ndryshme.

Rekomandime

Mediat duhet të përforcojnë qasjen profesionale dhe të thelluar analitike mbi eurointegrimet, ndërsa në këtë drejtim duhet të përforcohen kapacitetet e redaksive me gazetarë të specializuar të fushës, që do të shkojnë përtej deklaratave publike.

Nevojiten trajtime analitike mediatike, por edhe debate televizive dhe podkaste lidhur me status quonë, në të cilën gjendet vendi dhe si do të reflektohet kjo ndaj marrëdhënieve ndëretnike, raporteve midis pushtetit dhe opozitës, raporteve brenda koalicionit qeveritar, zhvillimit të ekonomisë me theks të veçantë ndaj tërheqjes së investimeve të jashtme dhe papunësisë. Fokus i mediave duhet të jetë edhe ndikimi i bllokimit të integrimit ndaj dimensionit demografik përkatësisht migrimit të qytetarëve jashtë vendit, në veçanti të "trurit", kryesisht në fushën e IT-së dhe mjekësisë.

Duhet të trajtohet çështja se a ka qeveria opsion rezervë që nënkupton aleancë me shtete të ndryshme, nëse dështon procesi i integrimit në BE, si pasojë e bllokimit nga Bullgaria fqinje dhe mosgatishmëria e pushtetit për t'u miratuar ndryshimet kushtetuese. Përveç zërave zyrtarë, ndër të cilët dominues është ai i kryeministrit dhe zëvendëskryeministrit, mediat duhet të bëjnë përpjekje të sigurojnë pluralizëm mendimesh lidhur me temën e eurointegrimeve, pasi nuk duhet të lejohet që qeveria të jetë filtruesja dominuese e deklarimeve publike mbi këtë temë.

Përveç kësaj, për publikun vendas nevojitet të shpjegohet edhe konteksti i sistemit politik bullgar, formimi i qeverisë së re dhe sa integrimi i vendit tonë zë vend në diskursin politik dhe mediatik të Sofjes dhe se a ka gjasa që të ndryshojë kursi i politikës bullgare ndaj Shkupit.

Duhet theksuar se asnjëra nga mediat shqipe nuk ka korrespondent të angazhuar në Bruksel, që do të thotë se në të ardhmen duhet të mendohet edhe për këtë dimension. Që të mos kemi gazetari që i ngjan "veza vezës", mediat e sidomos portalet duhet të angazhohen që të prodhojnë vetë lajme dhe përmbajtje autoriale mediatike, pasi kjo do të rrisë besueshmërinë dhe ndikimin e tyre publik.

